



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 5.2.2021, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7864, datë 29.9.1994 “Për Kryqin e Kuq Shqiptar”, nismë e një deputeti. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Rolant Xhelilaj, Almira Xhembulla, Klotilda Bushka, Ardiana Jaku, Florenc Spaho, Amra Barova, Majlinda Halilaj, Eugen Bojaxhiu, Koçi Tahiri, Edmond Stojku, Ervis Meço dhe Halil Jakimi.

I ftuar:

Ilir Beqaj – nismëtar

HAPET MBLEDHJA

Enver Roshi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë me këtë rend dite: projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7864, datë 29.9.1994, “Për Kryqin e Kuq Shqiptar”, nismë e deputetit Ilir Beqaj, për të cilin relatore është deputetja Ardiana Jaku.

Duhet thënë se ky projektligj është një përmirësim i ligjit aktual, pasi mungon njohja me ligj e datës së krijimit të Shoqatës, që është 4 tetori i vitit 1921, dhe propozohet që të rivendoset. Po kështu, në mënyrë harmonike, duhet që ligji të përmbajë në mënyrë të shprehur të paktën që KKSJ-ja është pjesë e lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të Kuq, pra Gjysmëhënës së Kuqe, pjesë e së cilës janë edhe 187 shoqata të tjera të Kryqit të Kuq, ka edhe ndryshime të tjera që rrjedhin, duke e parë me kujdes ligjin aktual të Kryqit të Kuq Shqiptar.

Unë nuk do të zgjatem shumë, pasi ftoj deputetin Ilir Beqaj për të bërë prezantimin e projektligjit në komisionin tonë.

Fjala është për ju, zoti Beqaj.

Presim pak.

Atëherë, sa zoti Beqaj të bëhet gati, unë po ia jap fjalën relatores Ardiana Jaku. Ardiana, po munde, rrotulloje pak kamerën, se është pozicionuar keq.

Ardiana Jaku – Faleminderit, zoti kryetar!

Mirëmëngjesi të gjithëve!

Po shqyrtojmë në këtë komision disa ndryshime në ligjin nr. 7864, që është i hershëm, pra i vitit 1994 për sa i takon Kryqit të Kuq Shqiptar.

Para se të nisim dhe të diskutojmë atë çfarë kolegu Beqaj ka dashur të propozojë nëpërmjet këtyre amendimeve, në fakt, kam nevojë të them disa gjëra paraprakisht lidhur me faktin se sa në vëmendje e ka pasur kjo qeveri ndihmën ndaj familjeve dhe personave më në nevojë. Ka qenë ky komision që edhe gjatë këtij mandati ka bërë disa ndryshime ligjore. Përmend këtu: ligjin “Për asistencën sociale, ligjin “Për strehimin social”, ligjin “Për nxitjen e punësimit”. Në mandatin e mëparshëm ishte ligji “Për shërbimet shoqërore”, si një paketë e plotë, e cila do të vinte në ndihmë ndaj familjeve dhe individëve në nevojë. Por e gjitha kjo nuk mund të kuptohet nëse ne nuk bashkërendojmë, le të themi, forcat dhe të gjitha kapacitetet tona edhe me organizatat e tjera që operojnë në territorin e Shqipërisë. Një nga këto është pikërisht edhe Kryqi i Kuq Shqiptar.

Ato çfarë kolegu ka dashur të përcjellë përmes këtyre amendimeve, në fakt, janë disa ndryshime edhe për sa i takon teknikës legjislativë, duke qenë... *(Nuk dëgjohet.)* që nuk shkonte me ndryshimet që kanë ndodhur përgjatë këtyre 26 vjetëve në Republikën e Shqipërisë.

Nëse më lejoni, zoti kryetar, dua t'i citoj shumë shkurtimisht ndryshimet e përcjella. Për sa i takon nenit 1 të propozuar në projektligjin e ri, në fakt...*(Nuk dëgjohet.)*...e para nga ligji ekzistues, duke e vënë theksin në datën e themelimit të Kryqit të Kuq Shqiptar, si një datë domethënëse për ata dhe për faktin se është krijuar që më 4 tetor të vitit 1921, pra është një ndër organizatat e para humanitare të themeluara në Shqipëri dhe, po ashtu, një ndër 38 organizatat e para të themeluara në rang botëror. Për këtë arsye dhe për faktin se ata kanë 100-vjetorin e themelimit të tyre, vinte edhe në mënyrë simbolike ky ndryshim në nenin e parë.

Neni i parë është i ndarë në katër pika, ku, siç e thashë, përmbledhen tri nenet e ligjit ekzistues. Në nenin e parë specifikohen data e themelimit, veprimtaria që vjen në një linjë me parimet themelore të lëvizjes...*(Nuk dëgjohet.)* të Kryqit të Kuq. Gjithashtu, cilësohet në pikën 3 që Kryqi i Kuq Shqiptar është ndihmës i organeve shtetërore në nivel qendror dhe lokal, si dhe respekton të gjitha konventat, kryesisht konventat e...*(Nuk dëgjohet.)*

Për të vazhduar më tej me, siç e thashë më lart...*(Nuk dëgjohet.)* ligjit ekzistues për faktin se janë përfshirë në nenet e para të ligjit...*(Nuk dëgjohet.)* Është edhe fakti që Kryqi i Kuq Shqiptar e ushtron veprimtarinë e tij në bazë të statutit që miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e tij.

Deri më sot statuti miratohej nga Asambleja e Përgjithshme, bazuar në të gjitha rekomandimet e marra nga Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq, më pas duhej të aprovohej nga kryetari i Këshillit të Ministrave, nga Kryeministri.

Duke qenë se kjo krijon ...*(nuk dëgjohet)*... fakti që ka ndryshuar situata në Shqipëri, kanë kaluar tashmë 26 vjet, është një shoqatë e konsoliduar, e cila ndjek të gjitha parimet dhe protokollet e vendosura në Konventën e Gjenevës, propozohet që të hiqet aprovimi nga kryetari i Këshillit të Ministrave *(nuk dëgjohet)* organizate, aprovohet vetëm nga Asambleja e Përgjithshme e tij dhe këtë e përmban neni 4.

Neni 5 i këtij projektligji ndryshon nenin 8 të ligjit ekzistues dhe specifikon që Kryqi i Kuq Shqiptar pranon kontribute të pakufizuara në çdo formë edhe nga ligjet e tjera, nga individë, ose persona fizikë dhe juridikë shqiptarë dhe të huaj dhe organizon mbledhjen e tyre brenda vendit.

Në njëfarë mënyre specifikohet që Kryqit të Kuq i jepet mundësia për të pranuar edhe donacione të tjera që rregullohen nëpërmjet ligjeve të tjera. Për shembull, në vendet e rajonit, apo *(nuk dëgjohet)* ...mund të pranojë donacione edhe nga vetë shteti, ndërkohë që aktualisht

ligji shqiptar ekzistues nuk e lejon këtë. Për shembull, nëse nga lojërat e fatit, apo nga lotaritë e ndryshme sigurohen të ardhurat, të mund të adresohet një pjesë e tyre edhe në ndihmë të Kryqit të Kuq, gjithmonë duke konsideruar edhe atë që specifikon ligji, që kjo shoqatë ka në thelbin e saj ndihmën humanitare, pra çdo gjë do të shkojë në koordinim me pushtetin qendror dhe vendor dhe do të jenë (*nuk dëgjohet*)... e monitoruar dhe e koordinuar bashkërisht.

Në fakt, këto janë dhe ndryshimet që propozon kolegu Beqaj dhe jam dakord, por duke u konsultuar edhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (që nuk kishin ndonjë koment), me propozimet e sjella dhe ftoj edhe kolegët që t'i kalojmë këto propozime sot.

Faleminderit, kryetar!

Enver Roshi – Propozimi i kolegut Beqaj pasqyron një risi në ndryshimin e ligjit mbi Kryqin e Kuq Shqiptar, aq më tepër që e vendos atë në kontekstin historik të kohës, pasi Kryqi i Kuq Shqiptar nuk është krijuar në vitin 1994, kur doli për herë të parë statusi i tij, por është krijuar në vitin 1921, pra një vit pas Kongresit të Lushnjës. Ne kemi një mirënjohje të veçantë nga Kryqi i Kuq Shqiptar drejtuar Komisionit për Shëndetësinë në lidhje me atë që ne bëjmë sot për të sjellë këtë ndryshim të amendamenteve të Kryqit të Kuq Shqiptar për ta bërë atë më bashkëkohor dhe më të njohur ndërkombëtarisht, por edhe për t'i dhënë hapësirë dhe mundësi Kryqit të Kuq Shqiptar të kryejë në mënyrë harmonike gjithë punën e tij në drejtim të shtresave në nevojë të Shqipërisë, apo dhe sfidave me të cilat përballet vendi ynë qoftë me tërmetin, pandeminë, apo dhe probleme të tjera të përditshme sociale në Shqipëri.

Edhe unë dua ta falënderoj deputetin Beqaj, i cili sjell vazhdimisht ndryshime të projektligjeve, një nga deputetët më produktivë, mendoj unë, të parlamentit Shqiptar dhe më aktivët, i cili sjell propozime me risi, prandaj duhet falënderuar në këtë aspekt.

Unë desha të ftoja deputetët që të bëjnë pyetje. Ndoshta Ardiana do të na përgjigjet për diçka, por një herë të shohim nëse zoti Beqaj është në linjë, apo jo.

Zoti Beqaj, a jeni në linjë?

Po ashtu të lidhemi me mënyra të tjera, ndoshta me telefon.

Ilir Pendavinji – Më fal, kryetar!

Enver Roshi – Po Ilir, përshëndetje!

Ilir Pendavinji – Më dëgjoni? Meqenëse kolegu Beqaj nuk po lidhet dot, atëherë parashtrimi i relatores është i saktë, mbase mund të plotësojë pak, por unë propozoj të jetë ajo që ta thotë fjalën dhe ta vazhdojmë mbledhjen dhe të ecë si proces.

Enver Roshi – Faleminderit!

Tani po e lidh zotin Beqaj drejtpërdrejt me telefon.

Po zoti Beqaj, fjala për ju.

Ilir Beqaj – Faleminderit, zoti Roshi!

Kolege dhe kolegë të nderuar,

Kërkoj ndjesë për vonesën dhe për pamundësinë për t’u lidhur!

Faleminderit për këtë transmetim të audios!

Projekti që kam paraqitur është një shqetësim i kahershëm, që vjen nga vetë Kryqi i Kuq Shqiptar, për faktin se duhet të pranojmë që është absurd i bërë në vitin 1994, në fund të fundit është mbështetur në atë eksperiencë që Shqipëria kishte në atë kohë. Në fakt, për të bërë të mundur funksionimin shumë më të mbarë të Kryqit të Kuq shqiptar, marrëdhënien e tij me Kryqin e Kuq ndërkombëtar, me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, si dhe të problemeve që ata kanë në funksionimin e tyre të përditshëm, unë ju kam paraqitur këto pak amendamente, të cilat në fakt, më shumë se sa ndihmojnë në komunikimin e Kryqit të Kuq shqiptar me Kryqin e Kuq ndërkombëtar dhe me Federatën Ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe... Për shembull, bazuar në eksperiencën e 1994-ës, midis të tjerash kërkohej që statutin e Kryqit të Kuq ta miratonte Këshilli i Ministrave.

Pavarësisht faktit se cilat mund të kenë qenë arsytet në atë kohë, në 1994-ën, ndoshta prezenca e shtetit mund të ketë qenë shumë e nevojshme, po sa i takon kohëve të sotme, mendoj se nuk është normale që Kryqi Kuq, që kërkon të ndryshojë statutin e tij, duhet të marrë miratim nga qeveria e radhës, cilado qoftë ajo.

Gjithashtu, për mendimin tim, një element i rëndësishëm është edhe neni 5 i projektit, që në fakt ndryshon nenin 8, për të krijuar mundësinë dhe hapësirën, që Kryqi i Kuq të mund të marrë financime në forma nga më të ndryshmet, dhe sigurisht t’i përdorë sipas misionit që ai ka.

Praktikisht, këto janë ndryshimet që propozohen këtu. Sigurisht, ju mund të merrni vetë kontakt me kryesinë e shoqatës “Kryqi i Kuq” në Shqipëri, por besoj se këto propozime të miat duhet të gjejnë edhe dakordësinë e tyre.

Enver Roshi – Faleminderit, zoti Beqaj, për prezantimin e projektligjit!

Natyrisht, siç e thashë edhe pak më parë, ky projektligj është sjellë në përmirësim të ligjit aktual “Për Kryqin e Kuq”.

Dëgjuam relatoren para jush, që për shkak të teknologjisë nuk mundëm të lidheshim. Nuk e di nëse ka ndonjë pyetje nga deputetët, në lidhje me projektligjin.

Po, Landi.

Rolant Xhelilaj – Duke vlerësuar kontributin e deputetit Beqaj, siç thatë edhe ju, që më tërhoqi vëmendjen në komentin e tij, pyetja është për Adrianën, si relatore.

Në lidhje me këto ndryshime, të cilat realisht e përmirësojnë situatën e Kryqit të Kuq Shqiptar, në kuadër të funksionimit të tij, duhet të kemi një përgjigje: a është njohur Kryqi i Kuq me to dhe a ka dhënë mendim?

Adriana Jaku –A mundem, kryetar?

Enver Roshi – Po, mundesh.

Adriana Jaku – Faleminderit, zoti Xhelilaj!

Në fakt, vetë Kryqi i Kuq na ka kthyer një përgjigje me shkrim, nëpërmjet të cilit vlerëson gjithë këtë nismë të kolegut Beqaj, por gjithashtu i rekomandon dhe i sugjeron komisionin tonë, që të jetë në dakordësi me të gjitha ndryshimet e propozuara. Pra, ata vetë kanë rënë dakord, janë shumë pozitivë dhe i mbështesin të gjitha këto ndryshime të sjella. Këtë na e kanë bërë të ditur me shkrim.

Enver Roshi – Po. Desha të thosha edhe pak më parë, se Kryqi i Kuq këtu ka sjellë një mirënjohje për Komisionin tonë të Shëndetësisë, në lidhje me projekt-propozimin e paraqitur nga deputeti Beqaj. Dakordimi midis Kryqit të Kuq dhe deputetit propozues ka qenë në harmoni të plotë, dhe ajo kërkesë është diskutuar dhe është sjellë në Komisionin e Shëndetësisë.

Ky është edhe informacioni paraprak, të cilin e konfirmon edhe dokumentacioni që kam këtu, në tavolinën time.

Faleminderit!

Ka pyetje ndokush tjetër? Nëse s'ka pyetje, unë them ta kalojmë projektligjin në votim. Atëherë, a jeni të gjithë dakord në parim, në lidhje me këtë?

Kush është dakord?

Pro? Kundër e abstenim nuk ka.

Miratohet!

Atëherë, vazhdojmë me projektligjin.

Neni 1. Pro? Kundër e abstenim, nuk ka.

Miratohet!

Neni 2. Pro? Kundër e abstenim, nuk ka.

Miratohet!

Neni 3. Pro? Kundër e abstenim, nuk ka.

Miratohet!

Neni 4. Pro? Kundër e abstenim, nuk ka.

Miratohet!

Neni 5. Pro? Kundër e abstenim, nuk ka.

Miratohet!

Neni 6. Pro? Kundër e abstenim, nuk ka.

Miratohet!

Votojmë projektligjin në tërësi.

Dakord?

Pro? Kundër e abstenim, nuk ka.

Miratohet!

Atëherë, miratohet projektligji i propozuar nga deputeti Beqaj, dhe kalon për votim në seancën e ardhshme parlamentare.

I urojmë suksese deputetit Beqaj!

Ju urojmë të gjithëve një ditë të mbarë!

Mirupafshim në takime të tjera!

Faleminderit!

Mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA